

RREGULLORJA “PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË ”

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	1/17

Neni 1

Parimet

- 1.1 Kjo rregullore rregullon veprimtarinë e Fakulteteve dhe Departamenteve të Universitetit “Western Balkans” në lidhje me programet e ciklit të parë të studimeve universitare dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë duke përfshirë provimet dhe vlerësimet.
- 1.2 Rregullorja e Programeve të Studimit të Ciklit të Parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë përcakton rregullat e funksionimit të këtyre programeve dhe të marrëdhënieve që krijohen ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse, në veprimtaritë e këtyre programeve. Ajo përcakton, strukturën e brendshme të angazhuar në lidhje me ndjekjen dhe realizimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë, mënyrën e funksionimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, raportet ndërmjet tyre, rregullat për pranimin e studentëve, mësimdhënien, kërkimin, praktiken, vlerësimin, diplomimin dhe parashikon sanksione në rast shkelje të rregullores.

Neni 2

Baza Ligjore

- 2.1 Kjo rregullore bazohet në ligjin 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e Universitetit Western Balkans miratuar me urdhrin nr. 69, datë 16.02.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e statutit të institucionit të arsimit të lartë jopublik “Western Balkans”.

Neni 3

Fushë veprimi

- 3.1 Kjo rregullore zbatohet për të gjitha programet e studimit universitar të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, të ofruara nga Universiteti “Western Balkans”. Programet e studimit në Universitetin “Western Balkans” zhvillohen në gjuhën shqipe dhe+ në gjuhën Angleze.

Neni 4

Çështje Studentore

- 4.1 Dekanati i çdo fakulteti është përgjegjës për përcaktimin e kërkesave të studentëve për transferimin e studimeve, pas vendimmarrjes së departamentit përkatës, si dhe për çështjet që lidhen me arsimin dhe provimet.
- 4.2. Në këto raste, studenti ka të drejtë të ankimojë vendimin pranë Dekanatit të Fakultetit brenda 15 ditëve nga marrja dijani e vendimit respektiv.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	2/17

4.3 Për çështjet e disiplinës, zbatohet e Kodi i Etikës së studentëve të Universitetit “Western Balkans”.

Neni 5

Pranimi dhe Regjistrimi i Studentëve

5.1 Studentët mund të regjistrohen në programet e studimit të ofruara nga Universiteti “Western Balkans” pasi të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit dhe të ndjekin procedurën e regjistrimit.

Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ose ekuivalencën e tij dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

5.2 Kriteret e pranimit të studentëve miratohen nga Senati Akademik brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe dërgohen në institucionet e MAS, QSHA dhe RASH. Kriteret publikohen në portalin U-Albania i cili është i aksesueshëm nga institucionet.

Kriteret e tjera caktohen vit pas viti me vendim të Senatit Akademik.

5.3 Për programet e studimit që ofrohen në gjuhën angleze, studentëve u kërkohet Certifikatë e njohjes së gjuhës angleze në nivelin B1 sipas CEFR, në një nga provimet e mëposhtme:

- Cambridge
- IELTS
- TOEFL Internet-based Test (iBT)
- TOEFL Paper-based Test (ITP)
- TOEIC
- GESE
- APTIS

Në mungesë të certifikatës së mësipërme të gjuhës së huaj angleze, studenti i nënshtrohet provimit të vlerësimit të mjaftueshmërisë së gjuhës së huaj. Në rastet kur studenti ka përfunduar studimet në një shkollë të mesme ku mësimi zhvillohet tërësisht në gjuhën angleze, ai është i përjashtuar nga detyrimi për të paraqitur këtë dokument.

Kriter pranimi në një program studimi të integruar të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	3/17

Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

5.4 Studentët shpallen fitues në portalin U-Albania dhe përcillen zyrtarisht pranë Universitetit “Western Balkans”. Pas këtij momenti studentit i lind e drejta të lidhë kontratën e arsimimit me Universitetin “Western Balkans”.

Studenti kur nënshkruan kontratën e arsimimit, angazhohet se gjatë të gjithë periudhës së studimit do të zbatojë rregulloret, udhëzimet e Universitetit “Western Balkans” dhe legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë në fushën e arsimit.

Periudha e regjistrimit të studentëve të vitit të parë, lista e dokumenteve të kërkuara dhe informacioni për procedurën e regjistrimit, përcaktohen dhe shpallen nga Rektorati i Universitetit “Western Balkans”. Me plotësimin e procedurave të regjistrimit, kandidati bëhet student i Universitetit “Western Balkans” dhe gëzon të gjitha të drejtat e studentëve.

5.5 Studentët që nuk kryejnë procedurën e regjistrimit përfundimtar në Universitet brenda afatit të përcaktuar, konsiderohen të tërhequr dhe nuk mund të pretendojnë asnjë të drejtë.

5.6 Për t’u regjistruar në një nga programet e studimit, studentit duhet të dorëzojë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar dokumentet e parashikuara me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Paraqitja e dokumentacionit të paplotë ose të rremë shkakton ndërprerjen e marrëdhënies mes studentit dhe Universitetit.

Neni 6

Këshilltari Akademik

6.1 Departamenti përkatës cakton një anëtar të stafit akademik me kohë të plotë si këshilltar akademik për çdo student. Roli i këshilltarit akademik është të mbështesë studentin gjatë gjithë periudhës së arsimimit të tij/saj në Universitet. Studenti së bashku me këshilltarin akademik është përgjegjës për përfundimin e regjistrimit të lëndës për çdo semestër. Çdo semestër, studentit nënshkruan formularin e regjistrimit të lëndës pasi merr miratimin e këshilltarit akademik.

Neni 7

Regjistrimi i lëndëve

7.1 Studentët që ndjekin studimet në Universiteti “Western Balkans”, janë të detyruar të kryejnë në mënyrë elektronike regjistrimet semestrale të lëndëve që do të frekuentojnë. Kryerja e regjistrimit bëhet në afatet e caktuara në kalendarin akademik.

7.2 Në rast se studentët nuk kanë shlyer pagesën e arsimimit, sipas kushteve të përcaktuara nga Universiteti, atëherë ata nuk mund të kryejnë regjistrimin semestral. Studentët të cilët nuk kanë kryer regjistrimin, nuk mund të ndjekin procesin mësimor dhe as të hyjnë në provime.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	4/17

Semestri për të cilin nuk është kryer pagesa arsimore do të llogaritet brenda periudhës studimore. Në programet e ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë marrëdhëniet me studentin ndërpriten, në rast se nuk përtërihet regjistrimi për katër semestra të njëpasnjëshëm. Në rast se studenti nuk shlyen në kohë pagesën, ai është i detyruar ti ushtrohet penalitetit të vonesës sipas kontratës së shërbimit.

Neni 8

Karta e studentit

8.1 Studentët pajisen me një kartë studentit me fotografi, të vlefshme jo më shumë se një vit, në rast se kanë plotësuar regjistrimin, pranë Universitetit “Western Balkans”.

Neni 9

Transferimet e studimeve

9.1 Universiteti Western Balkans ofron mundësi për transferime të studentëve ndërmjet programeve të të gjitha cikleve brenda Universitetit “Western Balkans”, apo nga/drejt institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

9.2 Universiteti “Western Balkans” pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike ose private dhe lejon transferimin e studentëve të saj në institucione të tjera.

9.3 Transferimet në programet e studimit të Universitetit “Western Balkans”i nënshtrohen kuotave të përcaktuara nga Dekanati i Fakultetit përkatës. Studentët pasi kanë përfunduar të paktën dy semestra, mund të aplikojnë pranë zyrës së sekretarisë mësimore brenda afateve të përcaktuara në kalendarin akademik, për t’u transferuar në një program tjetër brenda Universitetit “Western Balkans”.

9.4 Komisioni përkatës, i ngritur nga njësia bazë vendos për transferimet që kryhen në programet e studimit të Universitetit “Western Balkans”. Ky komision kryen të gjitha procedurat përkatëse të ekuivalentimit të lëndëve për programet respektive të studimit. Në përputhje me këtë nen, studentët e regjistruar në Fakultetet e Universitetit “Western Balkans”pajisen me diplomë vetëm pasi të kenë kryer të paktën dy semestra dhe të kenë plotësuar së paku 60 ECTS për programet e studimit bachelor dhe të paktën katër semestra ose 120 ECTS për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në Universitetin “Western Balkans”.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	5/17

Neni 10

Viti akademik

- 10.1** Viti kalendarik ndahen në vit akademik. Viti akademik organizohet në dy semestra të rregullt me së paku 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratorë në javë. Në bazë të rregullores përkatëse, organizohet dhe semestri veror, i cili nuk është i detyrueshëm.
- 10.2** Semestri i rregullt përfshin jo më pak se 14 javë kalendarike për zhvillimin e veprimtarive formuese dhe jo më pak se dy javë kalendarike për zhvillimin e provimeve përfundimtare.
- 10.3** Kalimi nga njëri vit te tjetri bëhet pasi studenti të ketë shlyer detyrimet e vitit të mëparshëm, në përputhje me Rregulloren Themelore dhe rregulloren e programeve dhe cikleve të studimit të Universitetit “Western Balkans”.
- 10.4** Në ditët e festave zyrtare nuk zhvillohen mësimet dhe provime.
- 10.5** Datat e fillimit dhe mbarimit dhe periudhat e provimeve të çdo semestri shpallen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati Akademik.

Neni 11

Kreditet sipas ECTS-së

- 11.1** Krediti i formimit të arsimit të lartë i referohet ECTS-së dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.
- 11.2** Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.
- 11.3** Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në një program studimi të ciklit të parë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.
- 11.4** Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.
- 11.5** Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe.
- 11.6** Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).

Neni 12

Njohja e krediteve

- 12.1** Universiteti “Western Balkans” mund të njohë si kredite të formimit universitar, në një program të caktuar studimi bachelor apo diplomë e integruar e studimeve të ciklit të dytë,

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	6/17

njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifike të programit të studimit. Për programin e ciklit të parë, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite ECTS dhe 90 (nëntëdhjetë) kredite ECTS për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.

Neni 13

Kohëzgjatja e Studimeve, Aktivitetet Mësimore dhe Gjuha e Mëimit

- 13.1** Programet e studimeve në Universitetin “Western Balkans” organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë. Zhvillimi i mëimit në Universitet do të jetë në Gjuhën Shqipe dhe Gjuhën Angleze. Në Universiteti “Western Balkans” mund të aplikohen programe në disa gjuhë. Me propozim të Dekanatit të Fakultetit dhe miratim të Senatit Akademik, lëndë të caktuara mund të zhvillohen në një gjuhë të ndryshme nga ajo e programit të studimit.
- 13.2** Programet e studimit mund të ofrohen edhe në një gjuhë tjetër me propozim të Senatit Akademik dhe miratim nga Ministria përgjegjëse për arsimin.
- 13.3** Kohëzgjatja normale e përfundimit të studimeve bachelor është gjashtë semestra. Periudha maksimale e studimeve është dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve. Kohëzgjatja normale e përfundimit të studimeve të integruara të ciklit të dytë është dhjetë deri në dymbëdhjetë semestra. Periudha maksimale e studimeve është dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve.
- Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Studenti mund t'i pezullojë studimet (për shkaqe të arsyeshme dhe të drejta), me anë të vendimit të Dekanatit, sipas parashikimeve në Rregulloren Themelore të universitetit.
- 13.4** Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj.
- 13.5** Procesi i arsimimit përbëhet nga leksionet, projektet dhe puna në studio, punimet në laborator praktikat, seminare, punimi i diplomimit dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor, si dhe çdo element tjetër të parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave për elementet që duhet të përmbajnë programet e studimit. Përveç rasteve kur vendoset ndryshe, kohëzgjatja e çdo lënde, projekteve zbatuese, laboratorëve dhe veprimtarive të ngjashme të saj, është një semestër.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	7/17

13.6 Gjuha e mësimdhënies në Universitetin “Western Balkans” është anglisht-shqip.

Neni 14

Elementët e programit të studimit

14.1 Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti “Western Balkans”, konsistojnë në:

- a. kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
- b. kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
- c. objektivat formues dhe kompetencat profesionale;
- d. veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
- e. kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;
- f. planin mësimor;
- g. kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;
- h. programin lëndor (Syllabus-et);
- i. profilin e programit;
- j. diplomën dhe suplementin.

Neni 15

Programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë

15.1 Arsimitimi në fakultetet dhe departamentet e Universitetit “Western Balkans” zhvillohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit të lartë, si dhe të Kartës së Bolonjës. Programet mësimore të departamenteve hyjnë në fuqi vetëm pasi Ministria përgjegjëse për arsimin ka miratuar hapjen e këtyre programeve. Lëndët me zgjedhje të programeve mësimore përbëhen nga lëndët me zgjedhje që hapen në fillim të semestrit nga departamenti për studentët e tij dhe nga lëndët me zgjedhje të hapura nga departamentet e tjera.

15.2 Studenti i cili, pas regjistrimit, paraqet një dokument të një institucioni të arsimit të lartë, në të cilin tregohet se ka përfunduar me sukses një ose më shumë lëndë, mund të kërkojë përjashtimin nga ndjekja e atyre lëndëve. Këshilli i Departamentit përkatës shqyrton kërkesën dhe nëse mendon se njohuritë që studenti ka përfituar në atë lëndë janë të mjaftueshme, mund ta çlirojë studentin nga detyrimi për të ndjekur lëndën. Në këtë rast, Këshilli i Departamentit vendos se cilat lëndë janë të detyrueshme për t’u ndjekur nga studenti.

15.3 Programet e studimeve të ciklit të parë referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vite

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	8/17

akademike. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Statut.

Programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, kanë një kohëzgjatje normale prej pesë deri gjashtë vitesh akademike, me kohë të plotë dhe realizohen me 300-360 kredite. Në përfundim të programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë, lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në fushën e arsimit të kryer.

15.4 Në rast se studenti nuk ka mundur të ndjekë lëndët të cilat duhet t’i ndiqte normalisht gjatë semestrit, për shkaqe të konsideruara si të arsyeshme nga Këshilli i Departamentit, atëherë ai mund të marrë lëndët pa parakushte (lëndë jo domosdoshmërisht të lidhura me njëra-tjetrën) në semestrin pasardhës. Studenti vijon studimet duke marrë fillimisht lëndët në të cilat ka rezultat jo kalues ose që nuk i ka marrë gjatë semestrave të mëparshëm. Puna praktike e përfshirë në programin e studimit zhvillohet nga njësitë përkatëse në kuadër të parimeve të përcaktuara, në përputhje me karakteristikat e arsimit të çdo departamenti.

Neni 16

Lëndët me parakushte

16.1 Parakushtet për ndjekjen e lëndëve të caktuara përcaktohen nga departamentet përkatëse dhe pasqyrohen në programin mësimor.

Neni 17

Regjistrimi në një lëndë, lënia e lëndës dhe detyrimi për frekuentim

17.1 Çdo student ka detyrimin për të marrë pjesë në leksionet, aplikimet, laboratorët, projektet, seminarët, punimet e diplomimit dhe punimet e ngjashme të semestrit që është duke ndjekur, brenda kufijve të përcaktuar në Kodin e Cilësisë dhe udhëzimin e Ministrit përgjegjës për arsimin.

Në rastet e përsëritjes ose të ndjekjes për herë të parë të leksioneve, laboratorit, projekteve dhe të aktiviteteve të ngjashme të barasvlefshme me leksionet, studentët duhet të regjistrohen më parë në lëndët në të cilat kanë marrë notën D dhe F. Pasi i kanë zgjedhur këto lëndë, atëherë mund të marrin dhe lëndë të tjera. Fillimisht merren lëndët e semestrave të shkuar, të cilat janë vlerësuar me D dhe F.

17.2 Studenti, pasi të ketë marrë miratimin e këshilltarit, brenda dy javëve që nga fillimi i çdo semestri, mund të tërhiqet nga një ose më shumë lëndë, mund të ndryshojë lëndët e marra me lëndë të tjera ose mund të regjistrohet në lëndë të tjera.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	9/17

17.3 Studenti ka detyrimin të ndjekë të paktën 75% të lëndëve teorike (leksione) dhe të seminareve dhe të paktën 80% të laboratorit dhe aplikimit. Studentët të cilët nuk përmbushin këto norma nuk hyjnë në provimin përfundimtar semestral.

Neni 18

Kursi dhe grupi

18.1 Mësimi zhvillohet në bazë kursi ose grupi.

18.2 Leksionet zhvillohen në bazë kursi deri në 150 studentë; seminarët në grupe jo më tepër se 50 studentë; punët laboratorike dhe praktikat profesionale në grupe më të vegjël deri më 20 studentë.

Neni 19

Diploma

19.1 Studentët të cilët përfundojnë me sukses studimet në fakultetet e Universitetit “Western Balkans”, në zbatim dhe përputhje të kësaj rregulloreje, pajisen me diplomën përkatëse, të regjistruar paraprakisht në Regjistrin e Diplomave dhe të Çertifikatave në Ministrinë përgjegjëse për arsimin.

Neni 20

NOTAT, PROVIMET DHE KALUESHMËRIA

Sistemi i vlerësimit të studentëve

Notat, provimet dhe kalueshmëria

Notat

Për çdo lëndë të ndjekur, studenti vlerësohet nga pedagogu në përfundim të semestrit me një nga notat e mëposhtme:

Nota (sipas sistemit shqiptar)	Shpjegimi i Notës	Vlerësimi i brendshëm i Universitetit Western Balkans		Koeficienti sipas sistemit amerikan
		Pikët	Nota Shkronjë	
10	Shkëlqyeshëm	90-100	A	4.00
9	Shumë mirë	85-89	A-	3.50
8	Mirë	75-84	B	3.00
7	Kënaqshëm	65-74	B-	2.50
6	*Mjaftueshëm me kusht	55-64	C	2.00
5	*Kalueshëm me kusht	50-54	D	1.00
4	Jo kalues	0-49	F	0.00

*Studenti i cili ka këto nota, duhet të ketë mesataren e përgjithshme mbi 7 për kalimin e vitit akademik dhe për diplomimin e tij.

Sqarime

I- Me mangësi

S- Mjaftueshëm

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	10/17

T- Transferuar

U- Pamjaftueshëm

P- Në vijim

EX- Përrjashtuar nga detyrimi

NI- Nuk përfshihet

NA - Nuk ka marrë pjesë.

Nota (I) jepet nga pedagogu i lëndës për atë student, i cili për shkak të një sëmundjeje ose të ndonjë shkakut tjetër të arsyeshëm, nuk ka mundur të plotësojë kërkesat e lëndës, edhe pse ka qenë i suksesshëm gjatë semestrit. Në rast se studenti ka marrë në një lëndë të caktuar notën I, ai është i detyruar që brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore të plotësojë mangësitë, në mënyrë që të marrë një notë. Nota që do të jepet në vend të notës I miratohet me

vendim të Dekanatit. Përndryshe, nota I shndërrohet në notën F. Megjithatë, në rastet e një sëmundjeje të gjatë ose në raste të ngjashme, me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe me miratim të Dekanatit, kohëzgjatja e notës I mund të vazhdojë deri në fillimin e periudhës së regjistrimeve në semestrin pasardhës.

Nota (S), i jepet studentit në lëndët në të cilat ai ka qenë i suksesshëm, por që nuk llogariten në mesatare.

Nota (T) jepet në rastet e transferimit horizontal nga një institucion tjetër i arsimit të lartë ose në rastet kur pranohet rezultati i një lënde të kaluar me, baras vlefshmëria e së cilës pranohet në bazë të vendimit të Departamentit. Nota (T) merret parasysh në llogaritjen e mesatares.

Për sa i përket lëndëve të marra gjatë programeve të shkëmbimit të studentëve, Departamenti vendos në lidhje me baras vlefshmërinë e krediteve dhe të notave të marra në këto lëndë.

Nota (U), i jepet studentit në lëndët në të cilat ai ka qenë i pasuksesshëm, por që nuk llogariten në mesatare.

Nota (P), i jepet studentit në lëndët në vazhdim të cilat nuk llogaritet në mesatare.

Nota (EX) i jepet studentit i cili përrjashtohet nga marrja e një lënde në vijim të një provimi të organizuar nga departamenti në ato lëndë të përcaktuara nga ana e Senatit. Studentit në fjalë nuk i njihen kredite nga lënda e marrë. Nota (EX) nuk llogaritet në mesatare, por pasqyrohet në listën e notave.

Nota (NI) jepet me qëllim përshkrimin e lëndëve në të cilat është regjistruar studentit, por që nuk llogariten në mesataren e notave. Kjo notë paraqitet në listën e notave të studentit së bashku me notën shkronjë që ai ka marrë në atë lëndë. Ngarkesa e lëndëve të cilat kanë këtë status nuk përdoren në procedurat e përrlogaritjes së lëndëve të programit ose programeve në të cilat studentit është i regjistruar. Lënda në të cilën studentit ka marrë notën (NI), nuk mund të përsëritet.

Nota (NA) i jepet nga pedagogu përkatës i lëndës, studentëve të cilët për shkak se nuk kanë zbatuar rregullat në lidhje me frekuentimin e lëndës ose nuk kanë plotësuar kushtet, në lidhje me praktikat ose aplikimin e lëndëve, kanë qenë të pasuksesshëm. Në llogaritjen e mesatares, nota (NA) konsiderohet si (F).

Neni 21

Kriteret e kalimit në vitin pasardhës

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	11/17

- 21.1** Studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë, kur ka siguruar të paktën 30 kredite të vitit të parë.
- 21.2** Studenti kalon nga viti i dytë në vitin e tretë, kur ka siguruar të paktën 60 kredite nga viti i parë dhe i dytë. Në këtë rregull procedohet edhe për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë.
- 21.3** Studenti i vitit të fundit që në përfundim të provimeve të vitit rezulton me 30 kredite të pashlyera, në rastet kur ka përmbushur detyrimin e frekuentimit të lëndëve, ka të drejtë t’i likujdojë ato në një periudhë të caktuar nga dekanati përpara sezonit të diplomimit. Në rast të kundërt studentit detyrohet t’i rimarrë këto lëndë vitin e ardhshëm.
- 21.4** Studenti që shlyen të gjitha detyrimet akademike ka të drejtë të hyjë në mbrojtjen e diplomës. Në rast të kundërt, i lind drejta e shlyerjes së tyre në semestrin pasardhës, ndërsa diplomimi bëhet pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike.

Neni 22

Përmirësimi i mesatares së përgjithshme

- 22.1** Studenti i cili dëshiron të përmirësojë notën mesatare të përgjithshme, mund të përsërisë lëndët e studiuara në vitet paraardhëse. Në llogaritjen e mesatares do të merret parasysh nota e fundit që ka marrë studentin në atë lëndë.

Neni 23

Nota kaluese

- 23.1** Nota kaluese në një lëndë, përcaktohet nga punimet përkatëse të kryera gjatë atij semestri të parashikuara si instrumente të vlerësimit të dijes (provimet gjatë semestrit, provimet gjysmë-finale, kuize, detyrat, projektet, ateliet, seminarët, pjesëmarrja në grupe pune, punët e laboratorit etj), së bashku me notën e marrë në provimin përfundimtar. Brenda javës së parë të çdo semestri, pedagogët duhet të publikojnë sistemin e vlerësimit në lëndët përkatëse.
- Rezultatet e arritura në çdo lëndë u dorëzohen organeve administrative të departamentit, brenda afatit të përcaktuar në kalendarin akademik dhe rezultatet publikohen në faqen personale të studentëve.

Neni 24

Sezoni i provimeve

- 24.1** Sezoni i provimeve zhvillohet pas përfundimit të çdo semestri. Në rast se një provim nuk realizohet dot brenda sezonit respektiv për shkaqe të pranuar si të arsyeshme nga Dekanati i Fakultetit përkatës, atëherë ky i fundit i propozon Senatit zgjatjen e sezonit të provimeve. Pas miratimit të Senatit sezoni i provimeve mund të zgjatet për aq ditë sa nuk janë kryer provime brenda afatit normal.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	12/17

Provimi i diplomimit/ mbrojtja e temës së diplomës zhvillohet pas sezonit të provimeve.

Neni 25

E drejta për të hyrë në provim

25.1 Studenti fiton të drejtën për t’u futur në provimin e një lënde kur ka shlyer detyrimet që lidhen

me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në syllabusin përkatës. Studentit i mohohet e drejta

për të hyrë në provim në rastin kur ka detyrime financiare.

25.2 Vlerësimi i lëndës bëhet sipas modaliteteve të përcaktuara për lëndën në syllabusin e saj .

Neni 26

Kalendari, vendi i provimeve dhe afatet e provimeve

26.1 Kalendari i provimeve gjysmë-finale dhe provimeve përfundimtare semestrare përcaktohet nga këshilli i departamentit përkatës dhe duhet të publikohet të paktën dy javë para fillimit të sezonit të provimeve nga administratori i fakultetit. Provimet kryhen në ambientet e Universitetit, në ditën, vendin dhe orën e caktuar në kalendar. Provimet e lëndëve të cilat zhvillohen në terren, në laborator ose me aplikim, mund të bëhen edhe jashtë godinës së Universitetit “Western Balkans”.

Lëndët e zhvilluara nga një pedagog vlerësohen vetëm prej tij, ndërsa kur lëndën e zhvillojnë disa pedagogë, të gjithë ata janë anëtarë të komisionit të vlerësimit.

26.2 Provimet dhe riprovimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik, të miratuar nga Senati dhe kalendarit të veprimtarisë akademike që shpallet në fillim të vitit akademik. Pas përfundimit të sezonit të provimeve finale, parashikohet sezoni i riprovimeve, sipas strukturës së miratuar me vendim të Senatit Akademik.

Ndryshimet e mundshme në kalendarin akademik bëhen të paktën një muaj para fillimit të sezonit të provimeve. Afatet e përcaktuara për provimet dhe riprovimet janë të detyrueshme për zbatim si për pedagogët, ashtu dhe për studentët.

26.3 Studenti nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde brenda një sezoni.

Studenti ka të drejtë të japë provim në të njëjtën ditë në lëndë të ndryshme, nëse e lejon orari i zhvillimit të provimeve, me kusht që të jetë regjistruar paraprakisht.

Neni 27

Forma e provimit

27.1 Provimet zakonisht bëhen me shkrim. Pedagogu i lëndës mundet që të vendosë ta bëjë provimin me gojë, në formë projekti ose detyre kursi.

27.2 Provimi përgatitet dhe drejtohet nga pedagogu i lëndës përkatëse. Në rast se pedagogu përgjegjës nuk ndodhet në ambientet e Universitetit “Western Balkans” ditën e provimit,

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	13/17

atëherë Përgjegjësi i Departamentit përcakton se kush do ta bëjë provimin. Të gjithë pedagogët dhe asistentët mund të ngarkohen me detyrë, me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së provimeve.

Studenti paraqitet në provim me një dokument identifikimi, ose kartën e studentit.

27.3 Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, me përjashtim të përgjegjësit të departamentit, dhe autoriteteve drejtuese të Universitetit.

Neni 28

Ankimimi ndaj rezultateve të provimeve

28.1 Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesë një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore. Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim.

Neni 29

Arsimimi gjatë semestrit të verës

29.1 Procesi mësimor gjatë semestrit të verës do të zhvillohet në përputhje me “Rregulloren e semestrit të verës”.

Neni 30

Vlerësimet

30.1 Vlerësimi i mëimit, aplikimit, laboratorit, projekteve, seminareve dhe punimeve përmblylëse nga pikëpamja akademike bëhet në bazë të njësisë matëse orë. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga orët e plota teorike në javë dhe gjysma e orëve javore të aplikimit, laboratorit, dhe projektit.

Neni 31

Nota mesatare e ponderuar

31.1 Studentëve në përfundim të programit të studimit ju njehsohet nota mesatare e ponderuar duke marrë në konsideratë edhe kreditet respektive për cdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese. Llogaritja e notës mesatare të ponderuar në bazë të udhëzimit nr. 15, datë 04.04.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, përftohet duke shumëzuar notën përfundimtare për secilën nga lëndët me numrin përkatës të krediteve; rezultati i shumës së produkteve të përfuara pjesëtohet me shumën totale të krediteve.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	14/17

Neni 32

Përfundimi i studimeve dhe diploma

- 32.1** Studenti, i cili ka kaluar me sukses në të gjitha lëndët e paraqitura në programin mësimor të fakultetit, nuk ka asnjë notë të vlerësuar me (D ose F) dhe ka përfunduar të gjitha punimet e parashikuara në këtë rregullore, pajiset me diplomën e përkatëse të programit të studimit.
- 32.2** Studentëve, të cilët në prag të diplomimit kanë jo më shumë se tre lëndë (D ose F), u jepet e drejta të përdorin vetëm një herë të drejtën e provimit shtesë për jo më shumë se tre lëndë në të cilat kanë marrë (D ose F) në përfundim të atij semestri. Në këtë rast nota e marrë në provim zëvendëson notën e marrë më parë.
- 32.3** Studentët të cilëve iu njihet e drejta e diplomimit, në mënyrë që të tërheqin diplomën duhet të paraqesin në njësitë kompetente dokumentet me të cilat tregojnë se nuk kanë detyrime ndaj institucionit.

Neni 33

Pezullimi i studimeve

- 33.1** Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

Studenti mund t'i pezullojë studimet për një periudhë maksimale prej 4 semestrash (për shkaqe të arsyeshme dhe të drejta), me anë të vendimit të Dekanatit. Kërkesa për pezullim studimesh duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga fillimi i semestrit. Periudha e kohës kur studenti ka pezulluar studimet nuk përllogaritet në kohëzgjatjen maksimale të studimeve në një program studimi që shkon respektivisht 6 vite për të përfunduar studimet e ciklit të parë dhe 10-12 vite për të përfunduar studimet e integruara të ciklit të dytë, të parashikuar nga kjo rregullore.

Në çdo rast studenti është i detyruar të njoftojë institucionin për pezullimin dhe rifillimin e studimeve.

- 33.2** Dekanati është organi kompetent për pranimin ose jo të kërkesës. Në vendimin për pezullimin e studimeve rregullohen efektet financiare të ndërprerjes si dhe përcaktohet një afat i mundshëm i rifillimit të studimeve. Vendimi i përcillet departamentit përkatës ku studenti zhvillon studimet, Zyrës së Sekretarisë Mësimore për zbatim si dhe Zyrës së Financës.

Studenti është i detyruar të paguajë tarifën e vendosur nga Bordi i Administrimit për çdo semestër që ka bërë pezullim studimesh. Studentit nuk i hiqet e drejta e zbritjes të tarifës së studimit të përfituar më parë.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	15/17

Neni 34

Rifillimi i studimeve

- 34.1** Studenti i rifillon studimet atje ku i ka ndërprerë, por gjithmonë në fillim të semestrit ose të vitit akademik, sipas programit të studimit të vitit akademik në të cilin kthehet. Kërkesa për rifillim të studimeve i drejtohet Zyrës së Sekretarisë Mësimore e cila ia dërgon departamentit përkatës dhe më pas departamenti e përcjell atë për miratim pranë Dekanatit të Fakultetit. Dekanati i Fakultetit përcakton për studentin detyrimet lëndore për përditësimin e dijeve.
- 34.2** Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit respektiv. Kreditet e grumbulluara nga studentit gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj.

Neni 35

Largimi nga Universiteti “Western Balkans”

- 35.1** Studentët të cilët do të largohen nga Universiteti “Western Balkans”, me dëshirën e tyre, duhet t’i drejtohen zyrës së sekretarisë mësimore e cila do të ndjekë procedurat e ndërprerjes së studimeve. Regjistrimi i këtyre studentëve fshihet vetëm në rast se ata paraqesin dokumente të marra nga njësitë përkatëse, të cilat dëshmojnë se nuk kanë asnjë detyrim ndaj Universitetit. Studentit të cilit i është fshirë regjistrimi, në bazë të kërkesës së tij, duhet t’i jepen dokumente të cilat japin informacion mbi arsimin e ndjekur prej tij deri në atë moment, diplomat e dorëzuara në fillim të studimeve dhe dokumente të tjera. Studenti është i detyruar të shlyejë detyrimet e tij për të gjithë semestrin në të cilin ndodhet.

Neni 36

Studentët e dërguar në kuadër të bashkëpunimeve me universitetet e huaja

- 36.1** Universiteti “Western Balkans”, në përputhje me marrëveshjet që mund të bëhen me universitetet jashtë, në kuadër të programeve të shkëmbimit të studentëve, mund të dërgojë studentët e tij për një ose dy semestra në universitetet e huaja me të cilat ka marrëveshje shkëmbimi studentësh. Regjistrimi i studentit në Universitetin “Western Balkans” vazhdon edhe gjatë kësaj periudhe, e cila llogaritet në kohëzgjatjen e arsimimit.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Neni 37

Studentët me aftësi ndryshe

37.1 Universiteti “Western Balkans” ofron mundësi për arsimimin e studentëve me aftësi të kufizuar dhe garanton që arsimimi i personave me aftësi të kufizuar të jete pjesë integrale e sistemit arsimor të saj. Mosdiskriminimi i studentëve me aftësi të kufizuar dhe garantimi i respektimit të parimit të barazisë është një ndër parimet e rëndësishme të Universitetit “Western Balkans”. Universiteti ka siguruar të gjitha facilitetet infrastrukturore dhe shërbimet mbështetëse, të projektuara në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuar për studentët në fjalë.

Neni 38

Studentët që përfitojnë zbritje nga tarifa e studimit

38.1 Në mënyrë që bursa që përfiton studenti të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, duhet që ai të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) Nuk duhet të marrë asnjë masë disiplinore;
- b) Duhet të diplomohet brenda kohëzgjatjes normale të studimeve;
- c) Mesatarja e përgjithshme vjetore (CGPA) e studentëve që kanë përfituar bursa ekselence nuk duhet të zbresë nën 8.5/10 (3.25/4), ndërsa për studentët që kanë përfituar zbritje institucionale mesatarja e përgjithshme vjetore (CGPA) nuk duhet të zbrese nën 7/10 (2.50/4.00).

Në rast të kundërt, bursa e studimit ndërpritet në përfundim të vitit akademik që ndodhet studenti.

Neni 39

Lëshimi i diplomave. Suplementi i diplomës

39.1 Studenti që ka plotësuar të gjitha detyrimet e një programi studimi pajiset me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.

39.2 Përmbajtja, forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës miratohen nga Senati Akademik,

në përputhje me udhëzimet e Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin dhe regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Diplomave dhe Certifikatave.

Neni 40

Tërheqja e Diplomës

40.1 Tërheqja e diplomës dhe e suplementit të diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

RREGULLORJA “PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË ”

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e Përditësimit	Faqe/Total
WBU -REG-007-AL	12.07.2022	0	0	17/17

40.2 Në se prania e të diplomuarit është objektivisht e pamundur, tërheqjen e diplomës dhe të suplementit të diplomës mund ta bëjë një nga pjestarët e familjes, i pajisur me prokurë të posaçme, duke paraqitur pasaportën e tij.

Neni 41

Hyrja në Fuqi

41.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik.

Neni 42

Zbatimi

42.1 Zbatimi i kësaj rregulloreje garantohet nga Rektori i Universitetit “Western Balkans”.

Njësia hartuese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati